



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

VENDIM

Nr. 20, datë 26.2.2014

**PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PROCEDURAT E BLERJES SË VLERAVE NUMIZMATIKE NË BANKËN E
SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” dhe shkronja “g” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 3 të Rregullores “Për procedurat e Prokurimit të Bankës së Shqipërisë” miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar, me propozimin e Kabinetit të Guvernatorit dhe Kryetarit të Entit Prokurues, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për procedurat e blerjes së vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë” dhe anekset e saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet çdo parashikim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 78, datë 08.12.2004 “Për miratimin e kriterëve për caktimin e çmimeve të blerjes dhe të shitjes për kartëmonedhat dhe monedhat metalike, vlera të tjera numizmatike, ambalazhe dhe katalogë si dhe të metodikës për llogaritjen e çmimeve të tyre”, i ndryshuar, që bie në kundërshtim me parashikimet e rregullores së miratuar me këtë vendim
3. Ngarkohen strukturat përkatëse të Bankës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI

Elvis Çibuku

KRYETARI

Ardian Fullani

RREGULLORE

“PËR PROCEDURAT E BLERJES SË VLERAVE NUMIZMATIKE NË BANKËN E SHQIPËRISË”

Kreu I TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për blerjen e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2 Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

- nenit 43, shkronja “c”, dhe shkronja “g” të ligjit nr. 8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar,
- nenit 3 të Rregullores “Për procedurat e Prokurimit të Bankës së Shqipërisë” miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 81, datë 15.11.2006, i ndryshuar, si dhe
- nenit 4, pika 2, shkronja “dh” dhe nenit 7, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

Neni 3 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuara ose të përdorura në Ligjin për Bankën e Shqipërisë.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:
 - a) “*Banka*” – është Banka e Shqipërisë;
 - b) “*Vlera numizmatike*” – janë kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të emetuara në vite dhe që nuk kanë kurs ligjor, kartëmonedhat dhe monedhat metalike shqiptare, të shtypura vetëm për qëllime numizmatike si dhe çeqet, bonot lekë dhe vlerat e tjera me karakter numizmatik, sipas përcaktimit nga Banka;
 - c) “*Koleksion numizmatik i munguar*” – janë vlerat numizmatike të cilat referuar listës së inventarit fizik në Bankën e Shqipërisë dhe listës që vërteton shtypjen dhe emetimin e tyre në periudhat përkatëse (publikuar edhe në katalogët ndërkombëtarë të monedhave e kartëmonedhave), mungojnë ose janë në sasi më të vogël se 5 copë.
 - d) “*Katalogë ndërkombëtarë*” – janë katalogët standardë ndërkombëtarë të kartëmonedhave dhe monedhave të tillë si “World Paper Money” dhe “World Coins”

të botuara nga Krause Publications INC etj, të cilët përdoren nga të gjitha organizmat numizmatike në botë.

- e) “*Gjendje fizike e vlerave numizmatike*” – është shkalla e cilësisë fizike të një vlere numizmatike sipas përcaktimit në këtë rregullore;
- f) “*Vlerë numizmatike e paqarkulluar (uncirculated, UNC)*” – është një kartëmonedhë e ruajtur në mënyrë perfekte, në të cilën letra është e pastër, nuk ka asnjë njollë, anët janë të drejta dhe të lëmuara, pa asnjë deformim të letrës dhe një monedhë, në të cilën nuk ka asnjë shenjë përdorimi apo prekje me dorë, me cilësi të njëjtë si ajo e ardhur direkt nga prodhimi;
- g) “*Vlerë numizmatike e shkëlqyer (extremely fine, XF)*” – është një kartëmonedhë shumë e mirë, e cila mund të ketë prekje të lehta me dorë dhe dy-tre rrudha të lehta në anët e kartëmonedhës (por që mund të jetë deformuar për shkak të paketimit apo të ambientit ku mbahet); dhe një monedhë metalike, e cila ka rreth 95 për qind të detajeve origjinale të dukshme ose një monedhë me asnjë dëmtim në detajet e brendshme të saj;
- h) “*Vlerë numizmatike shumë e mirë (very fine, VF)*” – është një kartëmonedhë e mirë por që ka përdorime të dukshme, ka përthyerje vertikale dhe horizontale, letra mund të ketë papastërti dhe njolla të lehta; dhe një monedhë metalike, e cila ruan rreth 75 për qind të detajeve origjinale të saj, germat dhe shifrat mund të jenë pak të konsumuara, monedha mund të jetë e një cilësie mesatare;
- i) “*Vlerë numizmatike e mirë (fine, F)*” – është një kartëmonedhë e cila ka qarkulluar konsiderueshëm, ka njolla dhe rrudha të dukshme; dhe një monedhë metalike, e cila ka rreth 50 për qind të detajeve origjinale të dukshme, ka germat dhe anët të konsumuara, ku në përgjithësi monedha duket e zbehtë;
- j) “*Vlerë numizmatike në kushte të mira (verygood, VF)*” – është një kartëmonedhë e përdorur, por akoma është e padëmtuar; dhe një monedhë metalike e cila ka të dukshme rreth 25 për qind të detajeve origjinale të saj;
- k) “*Specialist i jashtëm*” – është specialisti i fushës, që nuk është punonjës i Bankës së Shqipërisë, i përzgjedhur si bashkëpunëtor i jashtëm, i cili mund të jetë anëtar i Komisionit të blerjes në Bankë ;
- l) “*Ofrues*” – çdo individ, person fizik/juridik, që paraqitet pranë sporteleve të Bankës, për të ofruar për shitje vlere numizmatike;
- m) “*Çmimi i tregut*”- çmimi i përcaktuar nga Komisioni duke marrë për bazë çmimet që ofrohen në treg për vlerën numizmatike përkatëse, qoftë edhe vetëm nga një subjekt ose çmimet e gjeneruara nga rrjetet e tregtimit të këtyre vlerave *on-line*.

Kreu II

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR BLERJEN E VLERAVE NUMIZMATIKE

Neni 4

Blerja e vlerave numizmatike në Bankën e Shqipërisë

1. Banka, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, pasuron fondin numizmatik të saj me mbledhjen e vlerave të rralla numizmatike të vendit.

2. Banka mund të blejë kartëmonedha e monedha metalike dhe vlera të tjera numizmatike shqiptare, vetëm për plotësimin dhe/ose pasurimin e koleksionit numizmatik të munguar, pa të drejtën e tregtimit të mëtejshëm të tyre.

Neni 5

Koleksioni numizmatik i munguar

Zyra e Muzeut¹ harton listën e plotë të koleksionit numizmatik të munguar të Bankës, si dhe sasi të përkatëse të vlerave numizmatike që propozohen të blihen. Kjo listë miratohet nga Guvernatori.

Neni 6

Organizimi i blerjes së vlerave numizmatike

Blerja, rast pas rasti, e vlerave numizmatike në Bankë kryhet nga Komisioni i blerjes i ngritur për këtë qëllim.

Neni 7

Komisioni i blerjes së vlerave numizmatike

1. Ngritja e Komisionit të blerjes së vlerave numizmatike, kryhet me urdhër të Guvernatorit të Bankës dhe me propozim të Departamentit të Kërkimeve².
2. Komisioni i blerjes së vlerave numizmatike përbëhet nga një numër tek punonjësish të Bankës, jo më pak se 3 (tre) dhe jo më shumë se 5 (pesë) anëtarë.
3. Në përbërje të Komisionit mund të përfshihen jo më shumë se dy specialistë të jashtëm. Për vlerat numizmatike, monedha metalike me metal, ar e argjend, në rast se nuk ka një specialist të tillë në përbërjen e tij, Komisioni do të kërkojë mendimin e një specialisti të jashtëm, i cili do të bëjë vlerësimin për vërtetësinë e metalit që monedhat përmbajnë.
4. Komisioni i blerjes së vlerave numizmatike drejtohet nga kryetari i Komisionit, i cili përcaktohet në Urdhrin e Guvernatorit.
5. Kryetari i Komisionit është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës në Komision dhe zbatimin e të gjithë rregullave të përcaktuara në këtë rregullore.
6. Njëri prej anëtarëve të Komisionit do të jetë specialist i numizmatikës në Zyrën e Muzeut³.
7. Secili prej anëtarëve të Komisionit ka të drejtën e një vote. Komisioni vendos me shumicë të thjeshtë votash. Abstenime nuk lejohen. Në rast barazim votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

¹ Ndryshuar me vendimin nr. 72, datë 02.09. 2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

² Ndryshuar me vendimet nr. 72, datë 02.09.2015 dhe nr. 89, datë 03.08.2016, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë.

³ Ndryshuar me vendimin nr. 72, datë 02.09. 2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

8. Quorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjeve të Komisionit është gjithmonë jo më pak se 3 anëtarë.
9. Komisioni është përgjegjës për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të parashikuara në këtë rregullore, si dhe të detyrave shtesë që kanë lidhje me to të përcaktuara në urdhrin për ngritjen e tij.
10. Çdo mbledhje dhe veprim i Komisionit në lidhje me vlerat numizmatike dhe administrimin e tyre, evidentohet në procesverbale elektronike. Çdo procesverbal elektronik nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Neni 8

Kriteret për vlerësimin e vlerave numizmatike

1. Komisioni është kompetent për vlerësimin e çmimeve të vlerave numizmatike, pjesë e listës së plotë të miratuar të koleksionit numizmatik të munguar, objekt blerjeje. Për vlerësimin e çmimeve të këtyre vlerave, Komisioni zbaton kriteret e mëposhtme:
 - a) Vlerësimi i publikuar në katalogët më të fundit ndërkombëtarë, ku çmimi i blerjes është sa vlerësimi në katalogë referuar shkallës së gjendjes fizike të vlerës numizmatike.
 - b) Rrallësia e kartëmonedhës apo e monedhës metalike.
Për kartëmonedha e monedha metalike të rralla e me tirazh të vogël, siç janë: kartëmonedhat lokale të para vitit 1926, kartëmonedhat 100 Franga Ari të vitit 1926, 1 Frang e vitit 1945, si dhe disa monedha me material Ar, të viteve 1926-1938, vlerësimi i tyre do të bëhet duke krahasuar atë të publikuar në katalogët sipas pikës 1 më sipër, vlerën e llogaritur për peshën e metalit që ato kanë (për monedhat me metal Ar dhe argjend), shtuar me një marzh prej 50 për qind mbi vlerën e publikuar/llogaritur.
 - c) Gjendja fizike e vlerës numizmatike të munguar.
Vlerësimi i çdo vlere numizmatike do të bëhet duke iu referuar klasifikimeve të gjendjes fizike. Vlerësimi do të jetë sipas atij të bërë në katalogë përkatësisht:
 - i. për shkallën e cilësisë e klasifikuar si e paqarkulluar (*uncirculated-UNC*), jo më pak se 85 për qind e çmimit të publikuar;
 - ii. për shkallën e cilësisë e klasifikuar si ekstremisht e mirë (*extra fine-XF*), jo më pak se 65 për qind e çmimit të publikuar;
 - iii. për shkallën e cilësisë e klasifikuar si shumë e mirë (*very fine-VF*), jo më pak se 50 për qind e çmimit të publikuar;
 - iv. për shkallën e cilësisë e klasifikuar si e mirë (*fine-F*), jo më pak se 40 për qind e çmimit të publikuar;
 - v. për shkallën e cilësisë e klasifikuar si përgjithësisht e mirë (*very good-VG*), jo më pak se 30 për qind e çmimit të publikuar.Ky kriter nuk zbatohet për kartëmonedhat dhe monedhat metalike të përmendura në germën b) të pikës 1, të këtij neni.
2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, në rastet e vlerësimit të çmimeve të vlerave numizmatike shumë të rralla që nuk gjenden në katalogët ndërkombëtarë, ose në

rastet kur vlerësimi i çmimeve nga Komisioni, nuk pranohet nga asnjë ofrues, Komisioni do të përcaktojë çmimin e blerjes së vlerave numizmatike mbi bazën e çmimit të tregut.

3. Çmimet e blerjes së vlerave numizmatike duhet të përcaktohen në Lek. Në rastet kur ofruesi është i huaj, çmimet e blerjes mund të caktohen në monedhë të huaj, duke i bashkangjitur kursin e datës në të cilën caktohet çmimi.

Kreu III

PROCEDURA PËR BLERJEN E VLERAVE NUMIZMATIKE

Neni 9

Shpallja e njoftimit dhe ftesat e drejtpërdrejta

1. Komisioni bën shpalljen e njoftimit për blerjen nga ana e Bankës së vlerave numizmatike, në të paktën dy nga gazetatat kombëtare me tirazhin më të madh, në të paktën tre ditë të njëpasnjëshme, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Bankës.
2. Komisioni ka të drejtë të ftojë drejtpërdrejtë ofrues të ndryshëm, për të cilët ka dijeni, që ata të paraqesin vlera numizmatike për shitje.

Neni 10

Pranimi i vlerave numizmatike

1. Pranimi i vlerave numizmatike bëhet në Sportelin e Arkës Numizmatike, nga specialisti i zyrës së numizmatikës, anëtar i Komisionit të blerjes së vlerave numizmatike.
2. Vlerat numizmatike të ofruara për shitje duhet të shoqërohen me pasaportën e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës, ku sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi paraqitja e tyre është e nevojshme. Vlerat numizmatike të ofruara për shitje shoqërohen me foto të vlerës numizmatike, si dhe me një dokument identifikimi apo dokument tjetër të njohur ligjërisht që vërteton identitetin e ofruesit.
3. Çdo ofrues që do të paraqitet në sportelin përkatës për të dorëzuar vlerat numizmatike do të pajiset me një dokument, sipas Aneksit 1 të kësaj rregulloreje. Ky dokument vërteton dorëzimin e vlerave pranë sportelit të Arkës Numizmatike të Bankës.

Neni 11

Paraqitja e të njëjtës vlerë numizmatike nga dy ose më shumë ofrues

1. Në rast se për të njëjtën vlerë numizmatike dhe në të njëjtën kohë paraqiten dy ose më shumë ofrues, Komisioni do të vlerësojë në fillim vlerën numizmatike që është në gjendjen fizike më të mirë dhe në rast se ofruesi i saj nuk pranon vlerësimin, Komisioni do të vijojë me vlerësimin e vlerës numizmatike të radhës.
2. Në rast se vlerat numizmatike të paraqitura në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë ofrues, janë në të njëjtën gjendje fizike, Komisioni do t'ia bëjë të ditur vlerësimin

ofruesit që ka paraqitur i pari në kohë, vlerën numizmatike dhe nëse ai nuk pranon vlerësimin, Komisioni do t'ia bëjë të ditur vlerësimin ofruesit të radhës.

Neni 12

Vlerësimi i vlerave numizmatike

1. Komisioni për vlerësimin e vlerave numizmatike të paraqitura për shitje, mblidhet një herë në muaj (të hënën e parë vijuese pas Urdhrit për ngritjen e Komisionit). Në rast mosplotësimi të quorumit, Komisioni do të mblidhet të hënën vijuese ose me njoftimin e Kryetarit.
2. Komisioni, kryen vlerësimin bazuar në koleksionin numizmatik të munguar të miratuar dhe kritereve të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje, si dhe në përfundim të procesit të vlerësimit përcakton çmimet e vlerave numizmatike të paraqitura
3. Në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni harton procesverbalin sipas aneksit 2, të kësaj rregulloreje dhe ia bën të ditur këtë vlerësim, si çmim blerjeje, ofruesit të vlerave numizmatike.
4. Procesverbali sipas pikës 3 më sipër, mbahet në 3 (tre) kopje, nga të cilat një kopje i jepet ofruesit të vlerave numizmatike, një kopje mbahet nga Komisioni për të plotësuar praktikën e punës së tij dhe një kopje përdoret për ndjekjen e procedurave të mëtejshme (miratim, pagesë, hyrje në arkë etj..).

Neni 13

Përfundimi i procedurës së blerjes

1. Në rast se vlerësimi i bërë nga Komisioni pranohet nga ofruesi, atëherë ky i fundit konfirmon pranimin e çmimit që i është komunikuar paraprakisht nga Komisioni, me nënshkrimin e një deklarate dakordësie. Ofertuesit i komunikohet njëkohësisht se me nënshkrimin e kësaj deklarate, ai nuk fiton të drejtën për të kërkuar kryerjen e pagesës, e cila bëhet e kërkueshme vetëm në bazë të pikës 2 të këtij neni.
2. Për ato vlera numizmatike, vlerësimi i të cilave është pranuar dhe konfirmuar nga ofruesi, një kopje e procesverbalit i kalon për miratim Guvernatorit. Guvernatori miraton me urdhër të veçantë vlerësimin (çmimin e blerjes) e bërë nga Komisioni dhe urdhëron kryerjen e pagesës. Më pas procedohet me kryerjen e pagesës së ofruesit dhe regjistrimin e hyrjes së vlerave numizmatike në inventarë.
3. Në rast se vlerësimi (çmimin e blerjes) i bërë nga Komisioni nuk pranohet nga ofruesi, atëherë vlerat numizmatike i kthehen atij kundrejt një deklarate, e cila konfirmon se ky i fundit mori në dorëzim vlerat numizmatike të paraqitura pranë Bankës për shitje dhe arsyen e tërheqjes së tyre.
4. Në rast se vlerësimi (çmimin e blerjes) i bërë nga Komisioni nuk miratohet nga Guvernatori, atëherë, në urdhrin e këtij të fundit do të përcaktohet nëse:

- Vlerat numizmatike duhet të rivlerësohen edhe një herë nga Komisioni, i cili në këtë rast mund të kërkojë të ndryshojë përbërjen dhe numrin e tij;
 - Vlerat numizmatike duhet t'i kthehen mbrapsht ofruesit.
5. Me përfundimin e vlerësimeve të bëra nga Komisioni, vlerat e dorëzuara, të cilat nuk përbëjnë objekt blerjeje nga ana e Bankës do t'i kthehen ofruesit, kundrejt një deklarate të këtij të fundit me të cilën konfirmon se mori në dorëzim vlerat numizmatike të paraqitura për shitje, pranë Bankës së Shqipërisë, të cilat nuk janë pranuar për t'u blerë prej saj.

Neni 14 **Procedurat e pagesës**

1. Pagesa për vlerat numizmatike të ofruara dhe pranuar nga Banka, do të bëhet në numrin e llogarisë së vënë në dispozicion nga ofruesi i vlerave numizmatike. Nga pagesa që do i bëhet ofruesit, Banka e Shqipërisë do të mbajë çdo detyrim fiskal/tatimor sipas ligjit.

Neni 15 **Mospranimi i ofruesve**

1. Në rast se pas vlerësimit të bërë nga Komisioni, për çdo vlerë numizmatike, asnjëri prej ofruesve nuk pranon vlerësimin, Komisioni do të ribëjë vlerësimin e vlerave numizmatike, duke marrë për bazë këtë radhë çmimin e tregut dhe do të rikontaktojë me ofruesit e paraqitur.
2. Në rast se përsëri asnjë ofrues nuk pranon vlerësimin e Komisionit, atëherë ky i fundit ribën shpalljen e njoftimit dhe ridërgon ftesat.
3. Komisioni raporton tek Guvernatori, i cili mund të vendosë për shpërndarjen e tij.

Neni 16 **Mos paraqitja e ofruesve**

1. Në rast se pas shpalljes së njoftimit dhe/ose ftesave, sipas kësaj rregulloreje, nuk paraqitet asnjë ofrues, Komisioni ribën shpalljen e njoftimit dhe ridërgon ftesat.
2. Komisioni raporton tek Guvernatori, i cili mund të vendosë për shpërndarjen e tij.

Neni 17 **Anulimi i procedurës dhe/ose përsëritja e saj**

Guvernatori mund të vendosë për anulimin e procedurës së blerjes dhe/ose përsëritjen e saj, deri para miratimit të vlerësimit të bërë nga Komisioni, sipas pikës 2, të nenit 13 të kësaj rregulloreje, për shkak të të metave/ parregullsive të konstatuara.

Neni 18

Ankimi i ofruesve

1. Çdo ofrues është i lirë të ankohet për veprime ose mosveprime që konsiderohen prej tij shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Ankimi i paraqitet me shkrim Guvernatorit të Bankës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes në dijeni për rrethanat që janë objekt ankimi.
3. Ankimi nuk lejohet dhe nuk do të merret parasysh pas:
 - Miratimit të vlerësimit nga Guvernatori, sipas pikës 2, të nenit 13 të kësaj rregulloreje;
 - Përfundimit të procedurës së blerjes.
4. Me paraqitjen e një ankimi, procedura pezullohet deri në vendimin e Guvernatorit.
5. Guvernatori shqyrton ankimin dhe vendos brenda 3 javëve nga paraqitja e tij, për pranimin ose jo të ankimit dhe arsyet përkatëse. Në rast se vendoset pranimi i ankimit, Guvernatori përcakton masat korrigjuese që duhen ndërmarrë, si: rivlerësimi i vlerave numizmatike, kthimi i vlerave numizmatike tek ofruesi, ndryshimi i përbërjes ose numrit të Komisionit, kryerja e pagesës, shpërndarja e Komisionit, anulimi i procedurës së blerjes.. etj.
6. Vendimi i Guvernatorit është përfundimtar dhe i paankimueshëm.

Kreu IV REGJISTRIMI I HYRJES SË VLERAVE NUMIZMATIKE TË BLERA

Neni 19 Vlerat numizmatike që do të kalojnë në fondin e Muzeut të Bankës

Me vlerat numizmatike të blera, fillimisht, do të plotësohen vlerat numizmatike të munguara në fondin numizmatik të Muzeut të Bankës, deri në 2 (dy) copë për secilën prerje. Për regjistrimin e hyrjes së këtyre vlerave në inventarin e Muzeut kryhet veprimi si vijon:

Debi : Llogaria për fondin numizmatik të Muzeut;
Kredi: Llogaria e pastrimit për veprimet e Numizmatikës;

Neni 20 Vlerat numizmatike që do të kalojnë në fondin e paprekur të Bankës

Vlerat numizmatike të blera, pas plotësimit të fondit numizmatik të Muzeut, do të kalojnë në fondin numizmatik të paprekur (rezervë) të Bankës .

Për regjistrimin e hyrjes së këtyre vlerave në inventarin e fondit numizmatik të paprekur kryhet veprimi si vijon:

Debi : Llogaria Arka Stok Numizmatike Fond i Paprekur;
Kredi: Llogaria e pastrimit për veprimet e Numizmatikës;

Neni 21
Të fundit

Blerja e vlerave numizmatike në Bankë kryhet në bazë të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe jo sipas rregullave dhe procedurave të prokurimit të Bankës. Këto të fundit mund të gjejnë zbatim nëse nuk janë në kundërshtim me parashikimet e kësaj rregulloreje dhe përsa janë në përputhje me qëllimin dhe objektin e saj.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës

Ardian Fullani

Aneksi 1

Dokumenti i pranimit të vlerave në sportelin e Arkës Numizmatike:

BANKA E SHQIPËRISË XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX Arka Numizmatike				Datë : ___ / ___ / 20__	
<u>Dokument pranimi për vlerat numizmatike, për vlerësim</u>					
Në mbështetje të Rregullores “Për blerjen e kartëmonedhave dhe monedhave numizmatike në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. _____ datë. ___/___/2014, unë i/ nënshkruari.					
Emri _____ Atësia _____ Mbiemri, _____ me Dokument Identifikimi _____, banues në _____, numër telefoni _____ (në cilësinë e administratorit/ përfaqësuesit të subjektit _____) ⁴ jam dakord të dorëzoj pranë Bankës së Shqipërisë, vlerat numizmatike për vlerësim, si më poshtë dhe nëse jam dakord me vlerësimin e Bankës së Shqipërisë t’i japë këto vlera për shitje.					
Bashkëlidhur:					
<ul style="list-style-type: none">• Pasaporta e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të Pasurive.• Foto e vlerës numizmatike;• Dokument identifikimi/ dokument që vërteton identitetin e ofruesit					
Nr.	Emërtimi i plotë i vlerës numizmatike	Sasia (në copë)	Vlera (në lekë)		
xx	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX	xxxxx			
Për të marrë përgjigje do të paraqiteni më dt. ___/ ___/ ___					
Për Bankën e Shqipërisë Marrës në dorëzim			Dorëzuesi		
(_____)			(_____)		
(data dt/m/v/					

⁴Në rastin e subjekteve juridike

Aneks 2

Procesverbali tip për vlerësimin e vlerave numizmatike.

BANKA E SHQIPËRISË XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX KOMISIONI I VLERËSIMIT	Datë : ___ / ___ / 20__
<u>Procesverbal për vlerësimin e vlerës/ave numizmatike ofruar për shitje nga</u> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/>	
Në mbështetje të Rregullores “Për blerjen e kartëmonedhave dhe monedhave numizmatike në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. ____ datë. ___/___/2014, komisioni i vlerësimit bëri vlerësimin e vlerës/ave të dorëzuara në Bankën e Shqipërisë nga z/zj _____, në datë _____.	
Vlerësimi për secilën vlerë numizmatike të paraqitur, jepet në tabelën në vijim:	

Nr.	Emërtimi i plotë i vlerës numizmatike	Sasia (në copë)	Vlerësimi sipas katalogut për 1 copë	Vlerësimi sipas tregut për 1 copë	Vlerësimi komisioni (në lekë) për 1 copë	Vlerësimi gjithsej, për gjithë sasinë
xx	XXXXXXXXXXXXXXXXXX	xxxxxx				

Vlerë/a numizmatike të pa vlerësuar nga komisioni, të cilat i kthehen klientit.

Nr.	Emërtimi i plotë i vlerës numizmatike	Sasia (në copë)
xx	XXXXXXXXXXXXXXXXXX	xxxxxx

Shënime të tjera nga anëtarët e

komisionit.

Komisioni

(_____) (_____) (_____)

(_____) (_____) (_____)